

Emri i Lëndës : Kelam Sistematik

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 211	A	-1	4	0	0	4.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Ali Zaimi, Msc				
Asistenti dhe orari i konsultimeve			Aorel Senja, Msc				
Gjuha e kursit							
Niveli i lëndës							
Përshkrimi			Hyrje në kelamin klasik dhe metodat e tij të argumentimit. Do të trajtohen disa nga ekolet e ndryshme si dhe tematikat e para të kesaj shkence.				
Objektivat			Kjo lëndë synon që studenti të mësojë besimin e përbërjen e tij, metodat e argumentimit në kelam dhe klasifikimin e attributeve të Allahut.				

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Lindja dhe zhvillimi i shkencës së Kelamit. Në këtë leksion shpjegohen në mënyrë të detajuar rrethanat në të cilat lindi shkencë e Kelamit. Ashtu sikurse të gjitha shkencat e tjera fetare, edhe kjo shkencë lindi në bazë të nevojave të kohës për të strukturuar në mënyrë konkrete çështjet që lidheshin me besimin.
2	Përkufizimi, tematika dhe qëllimi i shkencës së Kelamit. Shkencë e Kelamit studion në mënyrë sistematike gjashtë bazat e besimit dhe përdor argumente racionale për vërtetimin e tyre. Në thelb të kesaj shkence qëndron besimi në Allah, nga i cili rrjedhjin edhe bazat e tjera të besimit.
3	Fraksionet (Medh'hebet) besimore dhe veçoritë e tyre. Kelami lindi në duart e medh'hebit Mutezili, i cili ishte një fraksion besimor që solli risi në këtë fushë dhe i jepte përparësi mendjes para shpalljes hyjnore. Në historikun e zhvillimit të shkencës së Kelamit lindën shumë fraksione, disa prej tyre humbën përgjatë historisë. Prej tyre mund të përmendim; Mutezile, Xhebrije, Kaderije, Xhehmije, Shia, Murxhie, etj.
4	Gjykimet fetare dhe ato logjike. Kelami përdor kryesisht argumentet racionale për vërtetimin e bazave të besimit, por fillimisht në këtë shkencë prezantohen edhe argumentet fetare që mbështesin çështje të caktuara.
5	Përkufizimi i besimit dhe mendimet rreth përbërjes së tij. Përkufizimi i besimit është një prej çështjeve më të rëndësishme të kesaj shkence. Ehli Suneti mban qëndrimin se esenca e besimit është bindja për ekzistencën e Allahut dhe pranimi i saj me zemër. Vërtetimin me gjuhë e konsideron të detyrueshëm që njeriu të njihet në jetën e kesaj bote, ndërsa veprat nuk i konsideron të jenë pjesë e besimit.
6	Klasifikimi i njerëzve nga ana e pohimit dhe mohimit: Kafir, Mushrik, Munafik, Mu'min. Në këtë temë jepet kuptimi gjuhësor dhe terminologjik i termave që lidhen sërish me çështjet e besimit. Njeriu mund të jetë besimtar, ateist, politeist, apo edhe hipokrit. Shpejgimi i këtyre termave është shumë i rëndësishëm, për vetë faktin se ai lidhet edhe me gjendjen e njeriut në jetën e përhershme.
7	Ekzistenca e Allahut dhe argumentet rreth saj. Ekzistenca e Allahut dhe besimi në të është tema kryesore e shkencës së Kelamit. Kjo ekzistencë mund të provohet me argumente fetare dhe racionale. Argumentet racionale kryesisht mbështeten në krijimin e përsosur të Zotit, i cili të çon edhe te një Krijues. Ekzistenca e Allahut konsiderohet si e detyrueshme sipas shkencës së Kelamit.
8	Provim Gjysmëfinal Studentët do të pyeten në lidhje me temat e shpjeguara deri në këtë javë të semestrit.
9	Gradët e besimit dhe relatat iman-islam. Besimi i njeriut mund të jetë imitues ose i vërtetuar. Sipas Kelamit, besimi në fillim mund të jetë imitues, por më vonë ai duhet të arrijë në gradën e vërtetimit, bazuar në argumente të ndryshme. Imani është gjendje e brendshme e njeriut, ndërsa islami është shfaqje e jashtme nëpërmjet veprave e saj që gjendet në zemër.
10	Mëkati i madh dhe relatat besim-mëkat i madh. Mëkati i madh dhe gjendja e mëkatarit të madh janë dy çështje shumë të rëndësishme të Kelamit. Mëkat i madh është ai për të cilin Allahu ka caktuar dënim në këtë botë, por edhe kërcënim për dënim në botën tjetër. Sipas Ehli Sunetit mëkatar i madh nuk del nga besimi. Ai duhet të pendohet për gjendjen e tij dhe nëse vdes pa u penduar, çështja i tij i lihet tërësisht Zotit. Nëse do, mund ta dënojë për mëkatin e tij, por nëse do, mund edhe ta falë pa e dënuar.

11	Klasifikimi itributeve të Allahut; Atributet Selbi. Atributet e Allahut dhe klasifikimi i tyre është një temë tjetër shumë e rëndësishme e shkencës së Kelamit. Në bazë tëtributeve Selbi, Allahun e njohim me gjërat me të cilat ai s'mund të cilësohet apo s'mund të jetë i tillë. Për shembull; ai nuk është materie, ai nuk ka ortak, ai nuk lind dhe as nuk është i lindur, etj.
12	Klasifikimi itributeve të Allahut; Atributet Thubuti. Atributet thubuti lidhen me disatribute hyjnore që në një formë të caktuar mund t'i gjejmë edhe në krijim, por këto cilësi janë absolute kur lidhen me Allahun. Ndër këto mund të përmendim; Dëgjimi, Shikimi, Jeta, Fjala, Krijimi, Vullneti, etj.
13	Klasifikimi itributeve të Allahut; Atributet Haberi dhe Fi'li. Atributet veprorë janë ato që lidhen me krijesat, siç janë; Dhëni e jetës, marrja e jetës, furnizimi, dërgimi i Profetëve, ringjallja, etj. Atributet Haberi ose metaforike, janë atotribute që në kuptimin e tyre të parë e përngjasojnë Allahun me krijesat. Disa dijetarë kanë zgjedhur t'i komentojnë këtotribute bazuar në disa rregulla të caktuara.
14	Lexime nga vepra "Fikhu'l Ekber" e Imam Ebu Hanifes. Vepra e Imam Ebu Hanifes është ndër të parat që është shkruar në fushën e Kelamit. Në këtë leksion do të lexohet teksti origjinal i kësaj vepre, në të cilin Imam Ebu Hanifja vendos çështjet e besimit sipas kuptimit të Ehli Sunetit.
15	Lexime nga vepra "Fikhu'l Ekber" e Imam Ebu Hanifes. Në këtë leksion do të përqendrohemi në shpjegimin e përmbledhur të tekstit origjinal të veprës. Sipas këtij komenti do të vërehet mbështetja e traktateve të Imam Ebu Hanifes në burimet bazë të fesë Islame.
16	Provim Final

Parakushtet	
Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • el-Magnisau, Sherhu'l Fikhi'l-Ekber, Daru'n-Nil, Izmir, 2007. • Yener Öztürk, Yeni Bir Yorumlu İslam İnanc Esasları, İşık Yayınları, İstanbul: 2014
Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Yener Öztürk, İslam İnancı Etrafında Yerli Yorumlar, Akademi Yay., İstanbul: 2008.
Punë laborator	
Përdorimi i komp.	
Të tjera	

Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

1	Studenti do të mësojë besimin e përbërjen e tij, metodat e argumentimit në kelam dhe klasifikimin etributeve të Allahut.
2	Studenti do të pajiset me njohuri rreth metodave të argumentimit në kelam.
3	Duke analizuar disa tema studenti do të shohë edhe praktikimin e këtyre argumentimeve.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	30
Kuize	0	0
Projekte	1	30
Projekte semestrare	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	0	0
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		40
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)

Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	2	2
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			126
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5,04
ECTS			5